

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE 'PERITUS' shpk

Fier, 19/10/2024

NENI 1

FORMIMI I SHOQERISE

Formohet Shoqeria me Përgjegjësi të Kufizuar, e themeluar nga Ortaket Z.Siwiek Ireneusz Slawomir lindur me 22.01.1972 me nr ID: H23122005H. Emertimi tregtar i shoqërisë do të jetë "PERITUS" sh.p.k. e cila ketu me posht në këtë kontratë do të quhet "Shoqëria"

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Qendra e Shoqërisë do të jetë në Shqipëri, në qytetin e Vlores, adresa juridike do të jetë :Ruga "Pavlo Filoko" me nr 04140338;Nd.38; Kodi postar: 9405;Vlore. Gjithashtu Shoqëria mund të krijojë edhe degë , filiale apo agjensi të saj Brenda ose jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

KOHEZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një kohë pa afat. Ajo mund të shpërndahet para afatit me vendim të Ortakëve, dhe për shpërndarjen e saj e përcakton vetë legjislacioni në fuqi.

NENI 4

ADMINISTRIMI

Shoqëria " PERITUS" shpk ka si administrator Z.Siwiek Ireneusz Slawomir.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- 1.Ofrimi i shërbimeve të IT si konsulencë në lidhje me fushën e teknologjisë së informacionit.
- 2.Ofrimi i kurseve online për mesimin e gjuhës së huaj angleze.
- 3.Ofrimin e shërbimeve të trajnimit për mesimin e sportit të Tenisit.



NENI 6

KAPITALI

Kapitali themeltar do te jete ne shumen 100.000 leke, e cila duhet te depozitohet ne Banken Raiffeisen dhe do te çelet llogaria e Shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqerise " PERITUS " shpk eshte 100.000 (Njeqind mije) leke dhe i perbere nga 1 kuot sipas kontributit te ortakeve si me poshte:

1. Z. Siwek Ireneusz Slawomir, kontribon ne shumen 100.000 (njeqind mije) leke te cilat perfaqsojne 100% te kapitalit themeltar dhe qe perbehet nga kontributet ne para ne shumen 100.000 (Njeqind mije) leke qe do te depozitohen ne Banken Raiffeisen ku shoqeria do te cele llogarine e saj likuiduese.

NENI 7

ADMINISTRIMI

Administrimi i Shoqerise do te behet nga nje administrator i vetem, person fizik, me detyren e te cilit palet bien dakort te ngarkojne Z. Siwek Ireneusz Slawomir, per nje periudhe nje vjecare duke filluar nga data e regjistrimit te Shoqerise, i cili e pranon kete detyre.

Organi vendimor i Shoqerise do te jete Asambleja e Ortakeve e cila do te mbidhet dhe do t'i marre vendimet sipas percaktimeve qe do te behen ne statutin e shoqerise, si dhe ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 8

VLEFSHMERIA E KONTRATES

Kjo kontrate mund te prishet prej seciles nga palet perpara afatit te percaktuar ne nenin 3 te saj, pasi te jete paraqitur me pare kerkesa me shkrim e pales tjeter, nga pala qe kerkon prishjen, te pakten gjashte muaj me pare.

Prishja e kesaj kontrate nuk eshte kusht i domosdoshem per prishjen e Shoqerise, e cila mund te vazhdoje ekzistencen e saj edhe me nje ortak te vetem.

NENI 9

ZGJIDHJA E MOSMARVESHJEVE

Te gjitha mosmarveshjet qe mund te lindin per zbatimin ose interpretimin e kesaj kontrate, palet do te perpiqen ti zgjidhin ne mirkuptim midis tyre, por ne rast se nje gje e tille do te behet e pamundur ato do te zgjidhen duke i u drejtuar gjykates se faktit te rrethit Vlore.

NENI 10

Persa nuk eshte parashikuar ne kete kontrate do te zbatohen rregullat e percaktuara ne Statutin e Shoqerise, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", Kodit Tregtar dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

Hartuar ne Fier
Me daten 19/ 10 / 2024

Ne kater kopjo origjinale.

O R T A K E T

Z.Siwiek Ireneusz Slawomir

